



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-8773/25 datë:22.04.2025



Npi – 01/154 datë: 30.04.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 30.04.2025 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 30.04.2025 (e mërkurë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtorët – z.Besnik Ahmeti, DBF: Asistentja e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët për Informim znj.Vlora Hyseni, dhe Albion Shabani.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 01.04.2025,
2. Raporti Tremujor Buxhetor Janar-Mars 2025,
3. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit Paraprak për dhënien në shfrytëzim pronat Komunale në Z.K-Shtime, Npi-01/25 dt.27.01.2025, sipas rekomandimit të MAPL - Nr.020-54/8-2025 dt.26.02.2025,
4. Propozim-Vendim për formimin e Komisionit të Aksionarëve për ndërmarrjen Publike Lokale “Ekosistemi” SH.A – Shtime,
5. Draft-Plani i punës të ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027, (Për diskutim publik)
6. Propozim-Vendim për Plotësimin e Komitetit për Komunitete,
7. Propozim-Vendim për zgjedhjen nga Kuvendi të dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për Student 2024/25.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 01.04.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 01.04.2025.**

Pika 2

Raporti Tremujor Buxhetor Janar-Mars 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për këtë pike, fjalën ja jap drejtorit Besnik Ahmetit për prezantimin e kësaj pike.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 45.4 të Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, ne jemi të obliguar që të prezantoj para jush Raportin tremujor Buxhetor Janar-Mars 2025.

Materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj unë do të ndalem vetëm te pikat kryesore të raportit të ndarjet sipas buxhetit të kategoritë ekonomike. Buxheti për këtë vit ishte 10.778.000€. Në vazhdim lexoi raportin në pikat kryesore. (Shih dokumentin) Ju ftoj që ta miratoni këtë raport, nëse ka ndonjë pyetje jamë i gatshëm të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa: Faleminderit drejtor për shërbimet. Unë i kam dy pyetje, te lejet e ndërtimit i keni planifikuar 240 mijë euro, sa janë realizuar? Dhe pyetja e dytë te taksat për shfrytëzimin e hapsirave publike janë realizuar vetëm 6% pse ka ndodhur kështu?

znj.Adelina Beqaj: Si çëndron puna me të hyrat vetanake, sa keni marrë? Dhe e dyta pse nuk po përmendet pjesa e shpenzimeve nga Përmbaruesi?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Te lejet ndërtimore është e kuptueshme se nuk ka pas kërkesa për leje ndërtimore. Te shfrytëzimi i hapsirave publike i kemi vetëm 6 %. Ndërsa sa i përket të hyrave vetanake këto i kemi të grumbulluara në fund të vitit, e mira është që këto mjete nuk shkojnë askund dhe do të vendosim që ti shfrytëzojmë për nevojat tona. Te Përmbaruesi kemi shkresa që janë ekzekutuar në muajin Prill, ndërsa në muajin Mars nuk kemi pas rast që Përmbaruesi na i ka marrë mjetet dikund në ndonjë kod buxhetor. Dhe në gjashtëmujorin e parë do të raportojmë për to.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për" me 3 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Raportit Tremujor Buxhetor Janar-Mars 2025.**

Pika 3

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit Paraprak për dhënien në shfrytëzim pronat Komunale në Z.K-Shtime, Npi-01/25 dt.27.01.2025, sipas rekomandimit të MAPL - Nr.020-54/8-2025 dt.26.02.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Po jap një shërbim pasi që drejtori nuk është present. Ne e kemi marrë një vendim paraprak për me i dhënë në shfrytëzim 2 parcela në Z.K. Shtime për Panele Solare, te Trafostacioni i rrymës nalt. Ka një ndryshim te sasia e hektarëve që janë në listë për tu dhënë në shfrytëzim, kështu që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal na ka dërguar një rekomandim ku kërkon që kjo pikë të rishqyrtohet edhe një here nga Kuvendi, për arsye se njëra pronë nuk është në listën e pronave që mund të epet në shfrytëzim afatgjatë, për këtë arsye tani ne duhet që këtë vendim ta ndryshojmë dhe në vendim të mbetet vetëm prona që është në listë. Besoj që drejtori në Kuvend do ta shpjegojë më mirë. Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa: Na vetë e kemi votuar këtë vendim, dhe çdo rekomandim që vjen nga MAPL-ja ne do ta votojmë, nuk ka fare problem sepse kjo është për zhvillim ekonomik.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për ndryshimin e vendimit Paraprak për dhënien në shfrytëzim pronat Komunale në Z.K-Shtime, Npi-01/25 dt.27.01.2025, sipas rekomandimit të MAPL - Nr.020-54/8-2025 dt.26.02.2025.**

Pika 4

Propozim-Vendim për formimin e Komisionit të Aksionarëve për Ndërrmarrjen Publike Lokale "Ekosistemi" SH.A – Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ju e dini se jemi në procedurë për themelimin e një Ndërrmarrje Publike Lokale "Ekosistemi" në Shtime. Tani për ta kompletuar nevojitet edhe formimi i Komisionit të Aksionarëve për Ndërrmarrjen Publike Lokale "Ekosistemi" për ta qar procesin përpara. Kështu

që tani unë kërkoj nga KPF-ja që ti rekomandojmë Kuvendit miratimin e vendimit për formimin e këtijë Komisioni. Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj. Adelina Beqaj: Unë po mendoj që duhet me i harmonizuar emrat e anëtarëve të Komisionit sipas subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend, sepse siç e dini në rastin e mëparshëm ka pas edhe përleshje fizike mes anëtarëve, unë jamë dëshmitare vetë sepse kamë qëlluar aty kur ka ndodhur përleshja, dhe i kam pa vetë se çka kanë bërë Rexha edhe Besniku.

z. Përparim Ramusa: Ne edhe në fillim kur është marrë vendimi për themelimin e kësaj ndërrmarrje kemi qenë “Kundër”, por Kuvendi e ka votuar. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit ne jemi dakord për me bashkëpunuar si parti politike. Është mirë që ti Kryesues me marrë sçarime të mjaftueshme se a duhet me qenë këta anëtarë të Kuvendit.

z. Kadri Emini: Ne e kemi obligim me e formuar Komisionin e Aksionarëve. Te “Pastërtia” në nivel Rexhional në Ferizaj janë 9 anëtarë të Komisionit, mirëpo aty ka edhe anëtarë të Komunave të rexhionit. Ndoshta në këtë ndërrmarrje duhet me qenë 5 anëtarë të Komisionit, kjo duhet të sçarohet deri në mbledhjen e Kuvendit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për formimin e Komisionit të Aksionarëve për ndërrmarrjen Publike Lokale “Ekosistemi” SH.A – Shtime.**

Pika 5

Draft-Plani i punës të ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027. (Për diskutim publik)

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik Planin e Punës të ekipit për të drejtat e fëmijëve 2025 – 2027.**

Pika 6

Propozim-Vendim për Plotësimin e Komitetit për Komunitete

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Përparim Ramusa: Sa i përket kësaj pike, ne i rekomandojmë Kuvendit plotësimin e Komitetit për Komunitete.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e vendimit për plotësimin e Komitetit për Komunitete.**

Pika 7

Propozim-Vendim për zgjedhjen nga Kuvendi të dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për Student 2024/25.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Përparim Ramusa: Ne si PDK-ë e propozojmë znj. Albana Podvorica, që të shkojë me rekomandim në Kuvend.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e Vendimit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për ndarjen e bursave për Student për vitin akademik 2024/25, me propozimin që nga subjekti politik PDK-ja të jetë kandidatja znj. Albana Podvorica.**

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Meqenëse diskutime të tjera nuk ka, mbledhjen e përfundoj në ora 11:07h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

